**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna e Kaçanikut**
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

**Drejtoria e Arsimit**

**Nr.**04-610/01-16909/23

**Datë, 17.07.2023**

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

**KONKURS**

Për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor **2023/2024**

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
   Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor **2023/24**, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MAShTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)**
- **Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe**
- **Certifikatën e lindjes.**
-

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe IAAP për vitin shkollor **2023/2024**, bëhet më datën **18, 19 dhe 20 korrik 2023**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **21.07.2023**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **24 korrik 2023**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MAShTI-t Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

| | | |
|---|---|---|
| **1. Suksesi nga shkollimi i obliguar** | **(40%)** | **40 pikë** |
| **2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar** | **(20%)** | **20 pikë** |
| **3. Numri i pikëve nga testi** | **(40%)** | **40 pikë** |

**Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%) 100 pikë.**

**Shih: Vendimin e MAShTI të datës 14.07.2023, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2023-2024.**

**IAAP ”Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” - Kaçanik**

| Nr. | DREJTIMI | PROFILI | Nr. i paraleleve | Nr.i nxënësve |
|---|---|---|---|---|
| 1. | ELEKTROTEKNIKË | - Elektronikë industriale | 1 | 32 |
| | | - Informatikë | 1 | 32 |
| | | - Instalues elektrik | 1 | 24 |
| 2. | EKONOMI | - Tregti me shumicë dhe pakicë | 1 | 32 |
| | | - Kontabilitet dhe tatime | 1 | 32 |
| 3. | MAKINERI | - Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit | 2 | 48 |
| | | - Automekanik | 1 | 32 |
| | | - Metalpunues | 1 | 24 |
| 4. | JURIDIK | -Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyres | 1 | 32 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5. | | Gjithsej | **10** | **288** |

**Gjimnazi "Skënderbeu" - Kaçanik**

| Nr. | DREJTIMI | Nr. i paraleleve | Nr.i nxënësve |
|---|---|---|---|
| 1. | Shkenca Natyrore | 4 | 128 |
| 2. | Shkenca Shoqërore- Gjuhësore | 3 | 96 |
| | Gjithsej | **7** | **224** |

Drejtori i DKA-së
z. Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA